



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .06.2025

**MBLEDHJA Nr. 27,
Datë 03.07.2025, ora 12:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte , datë 03.07.2025, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 27 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi disa ndryshime në Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.242, Datë 03.08.2023 sh.p.k “Mbi licensimin e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM “sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 50 MW.
2. Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.157, Datë. 31.07.2023 sh.p.k “Mbi licensimin e shoqërisë” H.K HEC GRABOVA 2” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi disa shtesa dhe ndryshime në kontratën tip për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe furnizuesi i shërbimit universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.”.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
7. Mbi marrjen e masave administrative për subjektet debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2024.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “ZENINA” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.

9. Mbi kërkesën e shoqërisë “ARIS ALBANIA” sh.p.k për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
10. Mbi kërkesën e shoqërisë “ARIS ALBANIA” sh.p.k për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
11. Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROPOWER” sh.p.k për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të paluajtshme të saj.
12. Informacion mbi analizën dhe vlerësimin e raportit vjetor të përputhshmërisë së operatorit të gazit natyror “ALBGAZ” sh.a., për vitin 2024.
13. Mbi përzgjedhjen dhe miratimin e Logos zyrtare të ERE-s .

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI